

20192443804

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 152/19) pas nenit 67, shtohen titulli i ri dhe neni i ri 67-a, si vijon:

"Mbështetje për nxitjen e prodhimitarisë bujqësore

Neni 67-a

(1) Mbështetje për nxitjen e prodhimitarisë bujqësore, ndahet për rritjen e qëndrueshmërisë së veprimtarisë bujqësore të ekonomive familjare bujqësore.

(2) Kushtet për realizimin e mbështetjes nga paragrafi (1) i këtij neni janë:

- ekonomia familjare bujqësore duhet të jetë e regjistruar në RUEB nga neni 15 i këtij ligji,
- në ditën e parashtrimit të kërkesës për ndihmë nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i ekonomisë familjare bujqësore të mos ketë më shumë se 40 vjet dhe
- ekonomia familjare bujqësore të mos ketë përdorur ndihmë nga neni 67 i këtij Ligji.

(3) Mbështetja nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet nëpërmjet planit afarist të aprovuar nga Agjencia, i cili duhet të parashikojë aktivitete investuese për modernizimin e ekonomisë bujqësore për periudhë prej së paku tre vitesh nga dita e aprovimit të mbështetjes.

(4) Plani afarist nga paragrafi (3) i këtij neni detyrimisht i përmban elementet në vijim:

- aspekte tregtare të investimit,
- përshkrim të investimit të planifikuar (investim i planifikuar, mekanizimi i nevojshëm, planifikimi i fuqisë së nevojshme të punës, etj.),
- organizim kohor,
- analizë financiare me kritere të përfshira për suksesin e investimit (neto vlera aktuale, shkalla e modifikuar interne e rentabilitetit dhe periudha e kthimit të investimit).

(5) Mbështetja nga paragrafi (1) i këtij neni ndahet në lartësi prej 1.200.000 denarësh për periudhën e realizimit të planit afarist dhe paguhet në nivel vjetor në të paktën tre këste.

(6) Mbështetja nga paragrafi (1) i këtij neni kushtëzohet me plotësimin e detyrueshëm të aktiviteteve të parashikuara të planit afarist nga paragrafi (4) i këtij neni."

Neni 2

Në nenin 71 paragrafi (1) alineja 2 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Alineja 3 ndryshohet si vijon:

"-shndërrimin e pyjeve të degraduara dhe shkurreve dhe pyjeve të djegura,".

Pas alinesë 3 shtohen dy aline të reja 4 dhe 5, si vijojnë:

"-vendosja e shtigjeve edukative, kullave vrojtimi dhe infrastrukturës tjetër të vogël (shtigje për rekreacion, pllaja, shenja informative, pllaka informative) dhe

- marketing i produkteve pyjore të drurit dhe jodrunore."

Paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) i cili bëhet paragraf (2), ndryshohet si vijon:

"(2) Shfrytëzues të mbështetjes nga paragrafi (1) alinetë 1,3,4 dhe 5 të këtij neni, janë ndërmarrje publike për ekonomizim me pyje shtetërore, pronarë të pyjeve private dhe/ose shoqata të pronarëve të pyjeve private."

Paragrafët (4), (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (3), (4), (5) dhe (6).

Neni 3

Neni 94-a ndryshohet si vijon:

"(1) Ndhimë për investime në përpunimin dhe marketingun e mbështetjes financiare për ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe kooperativa bujqësore, të cilat kanë lidhur marrëveshje për shfrytëzim të instrumentit për ndihmë paraaderuese për zhvillim rural për të paktën 30% të shpenzimeve të përgjithshme të parashikuara për investime në kapacitete pas grumbullimit dhe përpunuese.

(2) Lartësia e ndihmës nga paragrafi (1) i këtij neni, është deri në 100% të lartësisë së shpenzimeve investuese të pranuar në formë të parafinancimit të plotë ose të pjesëshëm të pjesës që i përket pjesëmarrjes vetanake në shpenzimet e përgjithshme të investimit.

(3) Parafinancimi dhe investimi është pagesa e shumës së ndihmës për realizimin e investimit të shfrytëzuesit para fillimit të investimit.

(4) Ndhimja realizohet me kërkesë të parashtruar në shpallje publike nga Agjencia.

(5) Ndhimja ndahet për shfrytëzues investimi i të cilëve përfshin rikonstruktimin e objekteve, blerje të pajisjes dhe vendosjen e kapaciteteve për aktivitete pas grumbullimit dhe/ose të përpunimit në bazë të kriterëve të cilat janë shënuar në shpalljen publike nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Ndhimja për investime në përpunim dhe marketing ndahet me marrëveshje të lidhur ndërmjet shfrytëzuesit të ndihmës dhe Agjencisë.

(7) Shfrytëzuesi i ndihmës është i obliguar që para lidhjes së marrëveshjes te Agjencia të dorëzojë garanci bankare për kryerjen cilësore dhe në kohë të marrëveshjes në vlerën e parafinancimit të aprovuar në pajtim me fazat për realizimin e investimit si garanci për kryerjen cilësore dhe në kohë të marrëveshjes nga paragrafi (6) i këtij neni. Garancia bankare për kryerjen cilësore dhe në kohë të marrëveshjes duhet të jetë pa kushte, e përvokueshme dhe e arkëtueshme në thirrjen e parë. Garancia bankare për kryerjen cilësore dhe në kohë të marrëveshjes duhet të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes.

(8) Shumën e parafinancimit të paguar për pjesëmarrjen e vet në shpenzimet e përgjithshme të investimit, shfrytëzuesi është i obliguar pas përfundimit ta kthejë në më së shumti tetë këste vjetore dhe e njëjta do të përcaktohet me marrëveshjen për shfrytëzimin e kësaj ndihme financiare.

(9) Në rast të mosplotësimit të obligimeve nga Marrëveshja nga paragrafi (6) i këtij neni, Agjencia e njofton shfrytëzuesin e ndihmës të njëjtën ta kthejë në afat prej 30 ditësh nga dita e arritjes së njoftimit.

(10) Nëse shfrytëzuesi i ndihmës nuk e kthen ndihmën në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, Agjencia do të bëjë arkëtimin e garancisë bankare të depozituar për realizimin cilësor dhe në kohë të marrëveshjes.

(11) Shfrytëzuesi i ndihmës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon ta tjetërsojë, ta japë si depozitë, ta lëshojë me qira ose në çfarëdo lloj mënyre tjetër ta ngarkojë investimin në afat prej 8 vitesh nga përfundimi i investimit, përpos për nevojat nga paragrafi (7) i këtij neni.

(12) Çdo marrëveshje ose vepër tjetër juridike me të cilën bëhet disponimi i investimit dhe/ose akt tjetër juridik në kundërshtim me paragrafin (11) të këtij neni është i pavlefshëm."

Neni 4

Në nenin 99-v paragrafin (1) pas fjalisë së parë shtohet fjali e re si vijon:

"Shfrytëzues i ndihmës plotësuese nga ky paragraf është edhe personi fizik i cili nuk ka qenë shfrytëzues i masës nga programi vjetor për mbështetje financiare në bujqësi për atë prodhim në vitet për të cilat vlen ndihma, nëse sasia e prodhimit bujqësor është grumbulluar nga ai person fizik ndërsa nuk është paguar nga grumbullues i regjistruar, nuk është më tepër se 30.000 kilogramë gjithsej për periudhën për të cilën vlen vendimi."

Neni 5

(1) Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë në afat prej 45 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në pajtim me Vendimin për përcaktimin e ndihmës plotësuese si masë për pagimin e rrushit të shitur për verë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 32/19) dhe Vendimin për plotësimin e Vendimit për përcaktimin e ndihmës plotësuese si masë për pagesën e rrushit të shitur për verë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 152/19) do t'i dorëzojë te Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, të dhënat për realizimin e të drejtës së ndihmës plotësuese në pajtim me nenin 4 të këtij ligji me të cilin plotësohet neni 99-v.

(2) Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të të dhënave të Inspektoratit Shtetëror të Bujqësisë do të kryejë pagesën e ndihmës plotësuese për persona fizikë të cilët i plotësojnë kushtet për realizimin e ndihmës në pajtim me Vendimin për përcaktimin e ndihmës plotësuese si masë për pagimin e rrushit të shitur për verë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 32/19) dhe Vendimin për plotësimin e Vendimit për përcaktimin e ndihmës plotësuese si masë për pagesën e rrushit të shitur për verë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 152/19) dhe në pajtim me nenin 4 të këtij ligji me të cilin plotësohet neni 99-v.

(3) Programi për mbështetje financiare në bujqësi për vitin 2019 në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të harmonizohet me nenin 4 të këtij ligji me të cilin plotësohet neni 99-v.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.